



SHBA-ja DHE BE-ja KËRKOJNË NGA KPK PROCES TË DREJTË PËR PËRZGJEDHJEN E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT

FAQE 4-5



Diplomatët e huaj në Kosovë kanë kërkuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) që ta bëjë punën e duhur dhe të mos vonohet për ta bërë përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit. Ambasadori amerikan

në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se i vjen keq që pas dy vjetëve i duhet ta përsërisë kërkesën ndaj KPK-së për një proces të drejtë, transparent dhe meritor për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit. Shefi i

Zyrës së Bashkimit Evropian, Tomas Szunyog, ka thënë se puna e KPK-së për zgjedhjen e Kryeprokurorit është shumë e rëndësishme, pasi vonesat mund ta dëmtojnë punën e prokurorisë dhe të gjykatave

AKTUALE



KUR DO TË NJIHET KOSOVA NGA KIEVI ZYRTAR? AMBASADORI UKRAINAS NË SHOIPËRI: NJOHJA ËSHTË NË AGJENDË F. 5

ABDIXHIKU: SI PARTI E QENDRËS SË DJATHTË, BESOJMË NË LIRINË EKONOMIKE TË GRUAS ME PËRÇJEGJËSI TË BARABARTË F. 3

MINISTRJA GËRVALLA TAKON HOMOLOGUN TURK, NË FOKUS THELLIMI I MARRËDHËNIEVE NDËRSHTETËRORE F. 6

EKONOMI



KTHIMI I SHISHEVE DO TA RUANTE XHEPIN DHE AMBIENTIN F. 7

RRITEN ÇMIMET, RËNDOHET JETA E FAMILJEVE ME PAGË MINIMALE DHE ATYRE ME SOCIAL F. 7

SPORT



'VRESHTARËT' VAZHDOJNË ME FITORE F. 10

DELIU-KODRA: ARRESTIMI I HASAN KRASNIQIT DHE ZYRTARËVE TË TJERË TË PUSHTETIT, DËSHMON PËR NJË QEVERISJE TREVJEÇARE KORRUPTIVE F. 3



VOTUESIT ZVICERANË VOTOJNË PËR PENSIONIN E 13-të BRENDA VITIT F. 6



RENOVA
 PUTZ
 Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
 Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
 +389 44 487 755
 Fac: +389 44 487 200
 Mbx: +377 44 501 289
 E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
 GROUP SH.P.K.
 NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
 INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
 FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
 044/256-051
 044/367-061
 028/532-617
 STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
 info@kolegji.biznesi.com
 030 500 878 | 045 500 878
 044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
 VIENNA INSURANCE GROUP
 SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
 Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
 Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
 E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
 Digital Agency
 Endrit Shaqiri
 +38344685122
 Internet Website, Marketing...

Stuhi të mëdha bore godasin përëndimin e ShBA-së

Uashington, 3 mars - Stuhi të mëdha të borës kanë përfshirë disa pjesë të Kalifornisë dhe Nevadas në përëndim të Shteteve të Bashkuara. Bora ka mbyllur rrugët, qendrat e skijimit dhe i ka lënë mijëra njerëz pa rrymë nëpër shtëpitë e tyre.

Stuhitë e kanë prekur posaçërisht zonën malore Sierra në Nevada, ku erërat kanë arritur deri në 305 kilometra në orë.

Njerëzit janë paralajmëruar për "rrezik të madh prej ndonjë orteku".

Parashikuesit e motit u kanë

bërë thirrje njerëzve të qëndrojnë aty ku janë përgjatë fundjavës, pasi mund të bllokohen në stuhi nëse lëvizin.

Ndërkohë, në disa pjesë të tjera të ShBA-së, vendet si Teksasi po përballen me ekstremin tjetër - zjarret pyjore.



Votuesit zviceranë votojnë për pensionin e 13 brenda vitit

BERN, 3 MARS - Zvicra ka votuar për rritje të numrit të pensioneve për të moshuarit, në një referendum të mbajtur të dielën, sipas parashikimeve preliminare të transmetuesit publik SRF. Sipas raportimeve, 58 për qind e pjesëmarrësve e kanë përkrahur një pension të 13 gjatë vitit, kurse 42 për qind kanë qenë kundër.

Kjo masë, që është shtyrë prej sindikatave të punëtorëve dhe partive të majta ose të qendrës, duhet ta ketë miratimin e shumicës së 26 kantoneve zvicerane.

Margjina e fitores nënkupton se diçka e tillë mund të arrihet, sipas transmetuesit zviceran. "Ky hap është një arritje e madhe prej perspektivës së sindikatave", ka thënë Lukas Golder prej kompanisë së sondazheve

gfs.bern, në disa komente për televizionin SRF.

Qeveria, organizatat biznesore lobuese dhe parlamenti, që tani ka shumicë të të djathtëve, e kanë kundërshtuar propozimin dhe e kanë konsideruar të papërshtatshëm financiarisht.

Në të kaluarën votuesit zviceranë kanë qenë të kujdesshëm në miratim të masave që i kanë konsideruar të rrezikshme për bizneset.

Votimi për pensionet është në kontrast me referendimet e mbajtura në dekadat e fundit në Zvicër, në të cilat janë kundërshtuar propozimet për shkurtim të ditëve të punës, apo të më shumë festave. Megjithatë, së fundi, kostoja e jetës përbën shqetësim të madh.

Cyrihu në Zvicër, bashkë me Singaporin, janë shpallur qytetet



më të shtrenjta në botë, sipas një studimi të publikuar në nëntor nga "The Economist Intelligence Unit".

Mery, një zvicerane 65-vjeçare, ka thënë se rritja e numrit të pensioneve ka kuptim. "Jam e pensionuar tani dhe natyrisht që dua më shumë", ka thënë ajo.

Ende nuk dihet se prej nga do të ndahen fondet për këtë rritje pensionesh, vendim që duhet të hyjë në fuqi më 2026.

Pensioni për të moshuarit në Zvicër është 1 225 franga në muaj dhe maksimumi është 2 450 franga.

Për çiftet shuma shkon në 3 675 franga.

Zviceranët kanë votuar edhe për iniciativën për ta rritur moshën e pensionimit, mirëpo është kundërshtuar me shumicë votash.

Gjermania kërkon që verërat e saj pa alkool të konsiderohen 'organike'



BERLIN, 3 MARS - Qeveria e Gjermanisë dëshiron ta ndryshojë rregulloren e Bashkimit Evropian për të mundësuar që verërat pa alkool të konsiderohen organike, ka thënë Ministria gjermane e Bujqësisë të dielën. "Kushdo që vendos të konsumojë verërat pa alkool duhet të ketë kualitet organik", ka thënë ministri i Bujqësisë, Cem Ozdemir, në një komunikatë për medie. Sipas rregullores aktuale, procedura e largimit të

alkoolit bën që një verë organike ta humbë certifikimin, sepse ky proces nuk është miratuar në mesin e metodave për të prodhuar verë organike. Prandaj Berlino po kërkon të ndryshohet rregullorja. "Me mbështetjen e vendeve të tjera anëtare, Gjermania e ka dorëzuar një kërkesë në Bruksel që vera e joalkoolizuar organike të miratohet sipas rregullave të BE-së", është thënë në deklaratën e ministrisë.

Në dokument është bërë me dije se Komisioni Evropian - trupi i vetëm që mund të propozojë zyrtarisht ligje të reja - e ka mbledhur një grup të pavarur të ekspertëve të produkteve organike për ta shqyrtuar mënyrën e largimit të alkoolit përmes distilimit me vakum. Sipas deklaratës, komisioni është zotuar për ta hartuar menjëherë dokumentacionin e nevojshëm, nëse grupi i ekspertëve e jep dritën e gjelbër.

Polonia heq kontrollet e përkohshme kufitare me Sllovakinë

VARSHAVË, 3 MARS - Polonia u ka dhënë fund kontrolleve të përkohshme kufitare me Sllovakinë fqinje të dielën. Varshava i pati kthyer kontrollet e tilla qysh prej tetorit të vitit të kaluar me qëllim të kontrollimit të migrimit të paligjshëm. Pezullimi i kontrolleve ka hyrë në fuqi në mesnatë, sipas

agjencisë polake të lajmeve PAP.

Ministria e Brendshme në Varshavë e ka arsyetuar këtë hap me "stabilizim të migrimit përmes së ashtuquajturës rrugë ballkanike". Megjithatë, situata do të vazhdojë të monitorohet, çka nënkupton se kontrollet mund të rikthehen mes këtyre dy

vendeve të BE-së, nëse është e nevojshme.

Polonia dhe Sllovakia janë anëtare të Zonës Shengen që mundëson lëvizje të lirë - prandaj nuk ekzistojnë kontrolle të rregullta kufitare. Mirëpo, prej fundit të vitit të kaluar vendet e bllokut evropian i kanë rikthyer me rastë këto kontrollet.



Deliu-Kodra: Arrestimi i Hasan Krasniqit dhe zyrtarëve të tjerë të pushtetit, dëshmon për një qeverisje trevjeçare korruptive

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MARS - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, të dielën, në një konferencë për medie, ka thënë se qeveria Kurti 2 është karakterizuar me afëra dhe skandale të shumta korruptive, të cilat kanë dëmtuar tejet shumë shtetin dhe mirëqenien e qytetarëve tanë.

Deputetja Deliu-Kodra ka thënë se rasti i fundit i arrestimit të kryeshefit ekzekutiv të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) në Gjakovë, njeriu i Lëvizjes Vetëvendosje, Hasan Krasniqi, është vetëm një nga vargu i gjatë i zyrtarëve të partisë në pushtet që është përfshirë në keqpërdorim të detyrës zyrtare. "Fillimisht, zgjedhja e tij kryeshef ka qenë në kundërshtim me ligjin për Ndërmarrjet Publike, pasi që parasheh që zyrtarët e lartë të ndërmarrjeve publike të jenë të pavarur, pra të mos kenë angazhime politike në 36 muajt e fundit. Ndërsa tani ai është edhe i dyshuar për vepra të tjera penale", ka thënë Deliu-Kodra.

Më pas, deputetja Deliu-Kodra ka përmendur disa nga zyrtarët e Vetëvendosjes të cilët kanë zënë ballinat e medieve me skandale dhe afëra. "Besnik Mujeci: asamblist i Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, i arrestuar në Shqipëri me 11 mijë e 300 tableta ekstazi, me vlerë tregu rreth 400 mijë euro. Nagip Krasniqi: ish-drejtuksi i Komitetit për Energji në Lëvizjen Vetëvendosje, tani kryeshef i Korporatës Energjetike të Kosovës, i arrestuar nën dyshimin e keqpërdorimit të pozitës zyrtare, ushtrimit të ndikimit dhe konfliktit të interesi. Nënshkrimi i kontratave të dyshimta në vlerë prej miliona



eurove. Faruk Mujka: ish-nënkryetar i komunës së Mitrovicës gjatë mandatit të Lëvizjes Vetëvendosje, për të cilin mediet kanë raportuar se si komuna e Mitrovicës në kohën sa udhëhiqej nga Agim Bahtiri, vendosi që sallën e leximit të bibliotekës në Mitrovicë ta shndërrojë në kafene. Ridvan Muharremi: mik dhe bashkëpunëtor i Vetëvendosjes, i cili është i përfshirë në skandalin e keqpërdorimit të rezervave shtetërore. Mbi 600 mijë euro është dëmi që Prokuroria Speciale e Kosovës thotë se i është shkaktuar buxhetit të shtetit", ka thënë Deliu-Kodra.

Në fund të kësaj liste, deputetja Deliu-Kodra ka përmendur edhe ambasadorin e Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, i cili, sipas saj,

është kupola e gjithë këtyre keqpërdorimeve. "Ambasadori Berishaj, si e dini, është përfshirë në një skandal të madh rajonal financiar në tregtimin e energjisë elektrike, i cili dyshohet se peshon miliona euro, ndërsa vetë ambasadori Berisha dyshohet se ka përfituar 600 mijë euro nga filiali i kompanisë GEN-I me seli në Beograd", ka thënë ajo.

Deputetja e PDK-së ka thënë se këto janë vetëm disa nga rastet, të cilat, edhe sipas raportimeve të medieve, dëshmojnë për një qeverisje trevjeçare të Lëvizjes Vetëvendosje përplot me afëra dhe skandale korruptive, të cilat kanë dëmtuar tejet shumë buxhetin e shtetit të Kosovës dhe mirëqenien e qytetarëve tanë.

"Në dritën e këtyre zhvillimeve dhe kësaj qeverisjeje, e cila ka qenë tejet

dëshpëruese, e paaftë dhe, në esencë, korruptive, natyrisht edhe raportet ndërkombëtare për vendin tonë nuk kanë se si të jenë as të mira dhe as pozitive. Raporti i fundit i 29 shkurtit nga Freedom House ka vlerësuar se Kosova është vend 'pjesërisht i lirë'. Sipas këtij raporti kredibil amerikan, me bazë në Uashington, institucionet e Kosovës mbesin të dobëta dhe korrupsioni i shfrenuar ka shkaktuar mosbesim të thellë publik ndaj qeverisë", ka thënë Deliu-Kodra.

Ajo ka thënë se sikur qeverisja e dobët dhe e dëmshme të mos mjaftonte, kryeministri dhe qeveria jonë po përkujdesen që edhe raportet e ndërtuara me mund me aleatët tanë të prishen. "Tashmë janë bërë tetë muaj që Kosova edhe zyrtarisht është nën

sanksione nga Bashkimi Evropian. Po mbeten të bllokua qindra miliona euro investime për shtetin tonë", ka thënë Deliu-Kodra.

Sipas saj, sot Kosova është peng i një qeverisje korruptive, të paaftë, që po dëmton buxhetin e shtetit të Kosovës, mirëqenien e qytetarëve tanë, të ardhmen evropiane të shtetit tonë dhe aleancat tona historike. Për këto arsye, Deliu-Kodra ka thënë se Partia Demokratike e Kosovës tashmë ka kohë që kërkon shpërbërjen e Kuvendit dhe zgjedhje të reja të parakohshme sa më parë.

Në fund të konferencës, deputetja Blerta Deliu-Kodra u ka bërë thirrje organeve të drejtësisë t'i trajtojnë me seriozitetin më të madh të gjitha aferat në të cilat është përfshirë kjo qeveri dhe zyrtarët e saj.


Abdixhiku: Si parti e qendrës së djathtë, besojmë në lirinë ekonomike të gruas me përgjegjësi të barabartë



PRISHTINË, 3 MARS - Lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, këtë të diel ka mbajtur një tjetër aktivitet me Forumin e Gruas, në të cilin ka folur për pavarësinë ekonomike të gruas dhe edukimin dhe aftësimin profesional si mjet drejt arritjes së këtij qëllimi.

Abdixhiku tha se si parti e qendrës së djathtë besojnë në lirinë ekonomike të gruas; përgjegjësi të barabartë e në përpjekje të përbashkët për krijimin e një shoqërie që i gërsheton vlerat tradicionale me kohët moderne. "Si parti e qendrës së djathtë ne

besojmë në lirinë ekonomike të gruas; besojmë në përgjegjësi të barabartë e në përpjekje të përbashkët për krijimin e një shoqërie që i gërsheton vlerat tradicionale me kohët moderne. Ky është misioni ynë ideologjik. Si organizim politik, besojmë në nevojën për krijimin e hapësirës së nevojshme për ekselencë për gruan që aktivizimin politik e ka përkushtim. Dhe LDK mbetet prijatë në këtë drejtim; jo me fjalë, por me shembuj përplot në qeverisje lokale dhe partiake gjithandej në Kosovë", ka theksuar Abdixhiku.



ShBA-ja dhe BE-ja kërkojnë nga KPK proces të drejtë për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit

Diplomatët e huaj në Kosovë kanë kërkuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) që ta bëjë punën e duhur dhe të mos vonohet për ta bërë përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit. Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se i vjen keq që pas dy vjetëve i duhet ta përsërisë kërkesën ndaj KPK-së për një proces të drejtë, transparent dhe meritore për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit. Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian, Tomas Szunyog, ka thënë se puna e KPK-së për zgjedhjen e Kryeprokurorit është shumë e rëndësishme, pasi vonesat mund ta dëmtojnë punën e prokurorisë dhe të gjykatave

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 MARS - Diplomatët e huaj në Kosovë kanë kërkuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) që ta bëjë punën e duhur dhe të mos vonohet për ta finalizuar përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit. Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se KPK-ja duhet t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm, në përputhje me standardet e qeverisjes së mirë, për ta rikthyer besimin e publikut dhe të partnerëve ndërkombëtarë në KPK si institucion publik. Ai i

ka bërë këto deklarata në konferencën vjetore të prokurorit të shtetit.

Hovenier ka thënë se i vjen keq që pas dy vjetëve i duhet ta përsërisë kërkesën ndaj KPK-së për një proces të drejtë, transparent dhe meritore për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit. "Dy vjet më parë mendoj se kam qenë pikërisht në këtë vend dhe kam kërkuar, kam bërë thirrje që Këshilli Prokurorial i Kosovës të sigurojë një proces të drejtë, transparent dhe të bazuar në merita për zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri të shtetit. Po e përsëris këtë kërkesë sërish dhe

me keqardhje që po e bëj dy vjet më pas", ka theksuar Hovenier.

Ai ka kërkuar nga prokurorët që të mos e rrezikojnë integritetin e tyre. "Jam i bindur që ndonjëherë është edhe ofenduese që të përballeni me kritika për shkak të punës që bëni, jo vetëm nga publiku, por edhe nga degët qeveritare që, po ashtu, kanë përgjegjësi për ta mbrojtur sundimin e ligjit në Kosovë dhe qeverisjen e mirë", ka thënë Hovenieri, duke përmendur në veçanti punën e bërë në marrëveshjen për pranim të fajësisë dhe atë për zgjidhje të kontesteve.

Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian, Tomas Szunyog, ka thënë se puna e KPK-së për zgjedhjen e Kryeprokurorit është shumë e rëndësishme, pasi vonesat mund ta dëmtojnë punën e prokurorisë dhe gjykatave. "Kjo zgjidhje e përkohshme me ushtrues detyre nuk duhet të stërzgjatet. Situata aktuale po ndikon negativisht në sistemin prokurorial dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet ta përbushë përgjegjësinë e tij për ta garantuar vendosjen e funksioneve të nevojshme

menaxhuese. Kam parë deklarata prej qeverisë në medie duke sulmuar punën e prokurorëve dhe të gjyqtarëve. I kam kritikuar publikisht, duke përmendur rëndësinë e pavarësisë së prokurorisë dhe gjykatave. Tentimet, me qëllim të dëmtimit të punës së tyre, janë të papranueshme dhe duhet të ndalen", ka thënë Szunyog, duke u bërë thirrje prokurorëve për sa më shumë transparencë në punën e tyre.

Në raportin e Indeksit për Perceptim të Korrupsionit për vitin 2023, të përpiluar nga organizata ndërkombëtare Transparency International, në pjesën për Kosovën është thënë se, pavarësisht prej përpjekjeve të vazhdueshme, reformat që janë kyçe për pavarësi të sistemit të gjyqësorit, sikurse krijimi i procesit të vettingut dhe miratimi i ligjit të ri, që do të mund të fuqizonte integritetin në Këshillin Prokurorial, janë duke lëvizur me ritëm shumë të ngadalshëm.

Në gjetjet më të reja të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, të përmbledhura në raportin më të ri të Pulsit Publik, është kuptuar

se shkalla e kënaqshmërisë së publikut ndaj gjykatave është 29.3 për qind, ndërsa 30 për qind ndaj Prokurorisë.

Me ligjin në Kosovë, Kryeprokurori duhet të dekretohet nga presidenti i shtetit.

Në tetor të vitit të kaluar presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, nuk e ka dekretuar Blerim Isufajn në postin e Kryeprokurorit të Shtetit, me arsyetimin se janë gjetur disa shkelje ligjore në procesin e përzgjedhjes.

Të zhgënjyer me procesin e përzgjedhjes kanë qenë edhe Bashkimi Evropian, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara.

Në garë për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, përveç Blerim Isufajt, kanë qenë edhe Armend Hamiti, Lulzim Sylejmani, Shqipdon Fazliu dhe Kujtim Munishi.

Kryeprokurorit të deritashëm të Shtetit, Aleksandër Lumezi, i ka skaduar mandati më 21 prill 2022. Aktualisht, ushtrues i detyrës është Besim Kelmendi, i cili i ka kompetencat e plota të Kryeprokurorit të Shtetit.

Brenda pesë vjetësh dyfishohet çmimi i banesave në Shkup



SHKUP, 3 MARS - “Për çdo ditë i kontrolloj shpalljet për shitje të banesave me shpresë se do të gjej një apartament të vogël për familjen time me çmim të arsyeshëm por, më kot, pasi çmimet kanë prekur tavanin”, thotë për Radion Evropa e Lirë, Marija Dineva.

Për të blerë banesë në lagjet periferike të Shkupit, vetëm për një metër katror që kushton rreth një mijë euro, asaj i duhet që për dy muaj ta lë pa prekur pagën prej 500 eurosh. “Në këtë kohë me këto paga, nuk e di kush është në gjendje të blejë banesë. Pa kredi

prej disa dhjetëra mijëra eurosh është thjeshtë pamundur të bleh banesë”, shprehet Maria. Ajo shton se çmimi për banesat që ajo ka shikuar për të blerë në lagjet periferike të Shkupit sillen nga 1 000 deri 1 300 euro për metër katror. “Ajo që më ka bërë përshtypje është fakti se banesat e vjetra, në periferi, për shembull në lagjen Hipodrom, Mazhari, çmimet e banesave për një metër katror sillen rreth 1 000 euro, përderisa banesat e reja në këto lagje arrijnë vlerën 1 200 deri në 1 300 euro për metër katror. Me të ardhurat që kam, është shumë e

vështirë të blihet një apartament në lagjet periferike të Shkupit e jo më në qendër ku çmimet janë më shumë se dyfishi i këtyre vlerave”, shprehet Marija Dineva.

Enti Shtetëror i Statistikave dhe Agjencia e Kadastrës në Maqedoninë e Veriut në pesë vjetët e fundit nuk kanë publikuar të dhëna për çmimin e banesave në Shkup, as për ato në qytetet e tjera të Maqedonisë së Veriut.

Radio Evropa e Lirë i ka pyetur këto institucione për arsyen, por deri në publikimin e këtij teksti nuk ka marrë përgjigje.

Të dhënat e fundit të publikuara

nga këto dy institucione janë të vitit 2019, të publikuara një vit më vonë, më 2020. Sipas këtyre të dhënave, çmimi i banesave për një metër katror në Shkup atëkohë arrinte vlerën mesatarisht rreth 1 000 eurosh.

Në bazë të agjencive që bëjnë ndërmjetësimin për shitblerjen e patundshmërive, një metër katror i një banese në lagjet periferike të Shkupit arrin vlerën e 1 000 eurove.

Në Komunën Qendër të Shkupit një apartament prej 40 metrash katrorë shitet rreth 80 mijë euro, përkatësisht 2 000 euro për metër

katrorë, kurse çmimi për banesat e reja sillen rreth 2 500 euro për metër katrorë.

Ndërtuesit thonë se në rritjen e çmimeve të banesave ka hise inflacioni, rritja e shërbimeve komunale, si dhe kostoja e ndërtimit.

Aliber Hamzai thotë se kursimet e fëmijëve që i ka në Gjermani i ka investuar në blerjen e banesave pasi, siç thekson ai, në këtë mënyrë kursimet shumëfishojnë vlerën kundrejt inflacionit të lartë. “Paraja e humb vlerën, ama banesa jo. Përditë e më shumë kushtojnë, edhe pse rrinë të zbrazëta”, thotë ai.

Kryetari i Shoqatës së Ndërtuesve pranë Odës Ekonomike nga ndërmarrja ndërtimore “Granit”, Andrea Serafimovski, thotë se çmimi për metër katror në pjesën qendrore të Shkupit tani ka tejkaluar vlerën prej 2 500 eurosh. Ai thotë se pret që këto çmime të stabilizohen, por jo edhe të kthehen në nivelet para krizës së pandemisë dhe asaj ekonomike. “Ai stabilizim i çmimeve do të reflektojë kostot reale, të ardhurat e kompanive, por do të reflektojë edhe shpërndarjen ndërmjet kërkesës dhe ofertës”, thotë Serafimovski.

Nga ana tjetër, Iskra Jankovska-Mihajlovska, kryetare e Kuvendit të Asociacionit të Arkitektëve në Maqedoninë e Veriut, për Radion Evropa e Lirë thotë se, krahas tregut që përcakton çmimin e banesave, për të qenë ato të përballueshme për të gjithë qytetarët, shteti duhet të ndërhyjë në rregullimin e çmimeve. Në të kundërtën, thekson ajo, një metër katror mund të arrijë edhe deri në 6 000 euro.

Kur do të njihet Kosova nga Kievi zyrtar? Ambasadori ukrainas në Shqipëri: Njohja është në agjendë

PRISHTINË, 3 MARS - Ambasadori i Ukrainës në Shqipëri, Volodymyr Shkurov, i ftuar në studion e emisionit “Kjo Javë” në “News24”, ka folur edhe për mundësinë e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Ukraina. Shkurov u shpreh se Kievi është i njoftuar me ndihmën e Kosovës për vendin e tij dhe se çështja e njohjes së pavarësisë është në agjendë. Megjithatë, ai u shpreh se fokusi kryesor i Ukrainës mbetet “dalja nga zjarri i luftës” me Rusinë, ndërsa shtoi se njohja e Kosovës ka karakter politik dhe se duhet të jenë të llogaritura edhe disa elemente të cilat, ndoshta, nuk duken në vija të përgjithshme. Diplomati ukrainas theksoi se “nuk ka gjë të pamundur” dhe se, sipas tij, aktualisht njohja e

Kosovës është “çështje kohe”. “Ne dimë për ndihmën e Kosovës dhe e vlerësojmë atë. Sigurisht që kjo çështje është në agjendë, siç e ka përmendur Ukraina, por sot po mendojmë si të dalim nga zjarri i luftës dhe çështja e Kosovës ka më shumë karakter politik. Duhet të jenë të llogaritura edhe disa elemente të cilat, ndoshta, nuk duken në vija të përgjithshme. Pata përshtypje se më shumë se gjysma e një fjalimi të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, i është dedikuar Kosovës gjatë një samiti të zhvilluar online. Kam takuar presidenten e Kosovës nga e cila kam kuptuar solidaritetin e plotë që ekziston ndaj Ukrainës. Nuk ka asgjë të pamundur. Aktualisht është çështje kohe”, u shpreh ai.



Ministrja Gërvalla takon homologun turk, në fokus thellimi i marrëdhënieve ndërshtetërore

PRISHTINË, 3 MARS - Mbështetja e Turqisë ndaj Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës, në NATO dhe organizata të tjera ndërkombëtare, fuqizimi i bashkëpunimit në shkëmbime tregtare dhe investime strategjike, ishin temat kryesore të diskutimit në takimim që

zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, pati me ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Hakan Fidan, në kuadër të ADF2024.

Më tutje, ministrja Gërvalla e njoftoi ministrin Fidan rreth prioritetëve të Republikës së

Kosovës në proceset integruese dhe fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar.

Gjatë këtij takimi bilateral u diskutua edhe rreth sigurisë në rajon dhe për nevojën e rritjes së bashkëpunimit multilateral për tejkalimin e sfidave të përbashkëta me të cilat po përballen shtetet demokratike.



ASK-ja: Shkalla e papunësisë në Kosovë ka arritur në 11.8 për qind

PRISHTINË, 3 MARS - Papunësia në Kosovë gjatë vitit 2022 ka arritur në 11.8 për qind, thuhet në raportin e fundit të publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, referuar në Anketën e Fuqisë Punëtore për vitin 2022. Por këto publikime të ASK-së nuk janë të sakta për përfaqësues të Sektorit Privat të Kosovës.

Shkalla e papunësisë ka arritur në 11.8 për qind. Kështu thuhet në publikimin e fundit të Anketës së Fuqisë Punëtore, tremujori i katërt 2022, të paraqitur nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, duke shtuar se mbi 38 mijë të papunë ishin më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Kryetari i Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemi, duke folur për Radio Kosovën, thotë se statistikave të ASK-së nuk janë shumë të sakta. "Vendet e punës po mbyllen, Enti ka dhënë shumë shifra që për ne janë jorelevante. Vetë fakti që ka thënë

që paga mesatare në Kosovë është prej 350-400, të bën me dije se ata nuk kanë statistika të sakta. Ne mund të themi gjithçka nga zyra, në terren, nëse hyjmë në çdo kompani në nivel të Kosovës, ka mungesë të punëtorëve. Është ulur papunësia, por nga ka ardhur kjo, sepse njerëzit kanë ikur nga Kosova, kanë dalë", tha ai.

Ndryshe në raportin e fundit të ASK-së theksohet se tregtia, ndërtimtaria dhe arsimiti prijnë me punësim.

Sektorët ekonomikë që prijnë me punësim vazhdojnë të jenë tregtia me 18.7 për qind, ndërtimtaria me 12.1 për qind, arsimiti me 10.3 për qind, administrata publike dhe mbrojtja me 9.2 për qind dhe prodhimi me 8.2 për qind. Raporti tregon se femrat kryesisht ishin të punësuar në sektorët e arsimit, derisa meshkujt në atë të tregtisë dhe ndërtimtarisë.



Mbahet konferenca vjetore e prokurorëve

PRISHTINË, 3 MARS - Në përkujdesjen e u. d. Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, është mbajtur Konferenca Vjetore e Prokurorëve të Republikës së Kosovës. Në këtë ngjarje të veçantë institucionale të Prokurorit të Shtetit, e cila është më e rëndësishmja vjetore e sistemit prokurorial, morën pjesë ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Fejzullah Rexhepi, kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Ardian Hajdaraj, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Albert Zogaj, drejtori i Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu, ish-kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kryeprokurorë dhe prokurorë të shtetit dhe udhëheqës dhe zyrtarë të stafit administrativ të sistemit prokurorial.



Ndër të tjera, përveç fjalimeve të rastit në pjesën e parë të konferencës, në sesionin e dytë pati paraqitje interesante për

avancimin dhe fuqizimin e proceseve të punës në sistemin prokurorial. Me këtë rast, prokurori në Zyrën e

Kryeprokurorit të Shtetit, Bahri Hyseni, paraqiti objektivat e Prokurorit të Shtetit për vitin 2024 dhe funksionalizmin e

Zyrës për Rikthimin e Aseteve, pastaj zëvendëskryeprokurori i PSRK-së, Valdet Gashi, paraqiti hyrjen në fuqi të Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe aspekte të kompetencave të kësaj prokurorie, prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Shqipdon Fazliu, trajtoi sekuestrimin dhe konfiskimin në procedurën penale dhe zbatimin e Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara të Konfiskimit, Shqipdon Fazliu, kurse kryetari i Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës, Naim Abazi, paraqiti draftin e Statutit të Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës, i cili u miratua unanimisht nga prokurorët, kurse Këshilltari Ligjor në Ambasadën Amerikane në Kosovë, John C. Hanley, paraqiti Programin Wake. Konferenca e Prokurorëve është ngjarje e përvitshme tradicionale dhe organizohet nga Kryeprokurori i Shtetit.

Konfiskohen mbi dy mijë euro false në Prishtinë

PRISHTINË, 3 MARS - Policia e Kosovës ka konfiskuar mbi 2 000 euro false në Prishtinë. "Ankuesi mashkull kosovar,

zyrtar i një banke, ka njoftuar se në intervalin kohor 3-mujor në bankë janë deponuar kartëmonedha

dhe monedha të ndryshme në vlerë totale prej 2053 eurosh që dyshohet se janë të falsifikuara. Nuk

raportohet për të arrestuar", thuhet në njoftimin e policisë. Rasti është duke u hetuar.



Kthimi i shisheve do ta ruante xhepin dhe ambientin

PRISHTINË, 3 MARS - Tash e 14 vjet Halil Avdiu, punëtor i ndërmarrjes publike komunale "Hortikultura", mirëmban parkun e lagjes Dardania në Prishtinë. Në një mëngjes të shkurtit ai kishte grumbulluar tre thasë me mbeturina - më shumë se gjysma e tyre mbetje plastike. "Këto po e shëmtojnë bukurinë e parkut", thotë ai, duke i treguar ekipit të REL-it thasët e mbushur kryesisht me shishe plastike të ujit dhe lëngjeve, por edhe me kanaqe alumini. "I hedhin edhe nga banesat lart, por edhe qytetarët që kalojnë apo qëndrojnë në park", thotë 51-vjeçari.

Produktet e plastikës konsiderohen të dëmshme për mjedisin, sepse shndërrohen në mikroplastikë dhe jetojnë gjatë, duke kërcënuar kështu botën e egër dhe përhapur toksina. Për t'i shkurtuar sadopak pasojat prej tyre, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Kosovës ka ndërmarrë disa hapa. Nga shtatori i vitit 2022 i ka bërë me pagesë qeset e plastikës, ndërsa në shkurt ka publikuar thirrjen për themelimin e Administratorit për Sistemin e Rimbursimit të Depozitave, i cili do t'i marrë nën menaxhim mbeturinat e plastikës, qelqit dhe aluminit. Kjo thirrje i paraprin fuqizimit të një udhëzimi administrativ për rikthimin e depozitave, që pritet të ndodhë nga 1 janari i vitit të ardhshëm.

Si do të funksionojë udhëzimi administrativ?

Zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Jeton Raka, thotë për Radion Evropa e Lirë se konsumatorët që blejnë produkte në shishe të plastikës, të qelqit apo në kanaqe, pas përdorimit, do të mund ta kthejnë ambalazhin e tyre. Në këmbim, ata do të marrin një



shumë të caktuar parash. Sipas Rakës, fillimisht është menduar që çmimi për të gjitha shisheet dhe ambalazhet nga 250 mililitra deri në dy litra të jetë pesë ose dhjetë centë. "Depozita do t'i kthehet qytetarit pasi që ai t'i kthejë shisheet në gjendje të kthyeshme", thotë ai.

Raka shton si i takon prodhuesit, importuesit dhe shitësit me pakicë të sigurojë që depozita i shtohet çmimit të produktit të ambalazhuar në momentin e shitjes, ndërsa i kthehet konsumatorit pas kthimit të ambalazhit. Për këtë qëllim, sipas tij, Kosova e ka mbështetjen edhe të partnerëve ndërkombëtarë, si Bashkimi Evropian dhe Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Disa qytetarë të anketuar nga REL-i në Prishtinë thonë se mezi presin zbatimin e kësaj nisme. Perihane Bunjaku thotë se do të përfitojë vetë materialisht në njërin anë dhe ambienti do të jetë më i pastër në anën tjetër. "Le të riciklohen dhe të shfrytëzohen prapë", thotë ajo. "Përveç mjeteve financiare, e rëndësishme është edhe ruajtja e ambientit. Po ndoten natyra, uji, ajri... Mbeturinat po e mbysin gjelbërimin", thotë edhe Merita Zymi.

Në disa vende të Bashkimit Evropian, ku Kosova mëton të anëtarësohet, aplikohen tashmë masa të ngjashme. Në Gjermani, për shembull, me skemën e kthimit të depozitave, konsumatorët nxiten t'i kthejnë shisheet prej qelqi dhe plastike në dyqanet me pakicë, ku ato mbledhen dhe riciklohen.

Shisheet të pijeve me pakicë u shtohet një tarifë shtesë, të cilën konsumatori mund ta rikuperojë pasi ta kthejë shisheet boshe.

Bashkimi Evropian nga korriku i vitit 2021 ka fuqizuar direktivën që e ndalon plastikën për një përdorim, përfshirë këtu: pjatat, gotat, shkopinjat për pirje dhe qeset. Kjo plastikë, sipas vlerësimeve të BE-së, përbën rreth 70% të mbeturinave detare në Evropë. Qëllimi përfundimtar i BE-së është që deri në vitin 2030 çdo plastikë e mbetur të jetë e ripërdorshme ose e riciklueshme. Sipas ekspertëve, riciklimi i mbeturinave të plastikës redukton mbetjet që groposen, zvogëlon ndotjen, ruan burimet natyrore e të tjera. Lorik Muçaj, themelues dhe drejtor ekzekutiv i organizatës joqeveritare Green Art Center, thotë se vendosja e taksës mbi produktet me ambalazh plastike, qelqi ose alumini, është "lajmi

më i mirë" për mbrojtjen e ambientit. "Mbeturinat e plastikës krijojnë dëm jashtëzakonisht të madh jo vetëm mjedisor, por edhe ekonomik", thotë ai, duke aluduar në shpenzimet që bëhen për mbledhjen dhe groposjen e tyre.

Ai shpreh bindjen se kthimi i shisheetve do të krijojë një ambient më të pastër në Kosovë. Por, shton se për këtë nevojiten fushata vetëdijesuese si nga institucionet qeveritare, po ashtu edhe nga operatorët privatë.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë se në vitin 2022 sasia e mbeturinave të trajtuara dhe deponuara në Kosovë ka qenë mbi 521 mijë tonë. Prej tyre, 35 për qind kanë qenë mbeturina të plastikës.

Në Kosovë operojnë pesë deponi sanitare, që funksionojnë në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive.

Ministri i Mjedisit, Liburn Aliu, ka paralajmëruar në fund të janarit se "në përputhje me strategjinë e re të mbeturinave, që e ka për synim riciklimin, do të fillojë ndërtimi i qendrave të riciklimit nëpër të gjitha rajonet e Kosovës". Megjithatë, ai nuk ka dhënë detaje se kur të do të fillojë

ndërtimi i tyre.

Si është e rregulluar kjo çështje në rajon?

Në Maqedoni të Veriut, për shembull, Ministria e Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ka hartuar një rregullore për grumbullimin e shisheetve të plastikës. Për zbatimin e saj ajo ka autorizuar kompaninë "Pakomak", e cila në disa pika të Shkupit dhe qyteteve të tjera ka vendosur aparate ku qytetarët mund t'i hedhin shisheet e plastikës. Atje ekziston, po ashtu, aplikacioni "Ecomak", që mund të shkarkohet nga qytetarët dhe ta regjistrojnë hedhjen e shisheetve. Me atë rast ata fitojnë "pikë të gjelbra", varësisht prej mbetjeve të hedhura. "Pikët e gjelbra" pastaj mund të shkëmbehen për përfitime të ndryshme, si: vauçer për zbritje në markete dhe objekte të tjera shitjeje, zbritje gjatë pagesës së shërbimeve publike, donacione etj.

Në Serbi, ndërkaq, ekziston një depozitë për shisheet të qelqit, por vetëm për disa lloje të produkteve - kryesisht birra.

Kur konsumatori i kthen ato shisheet të zbrazëta, mund të marrë shisheet të mbushura pa ndonjë pagesë shtesë.

Kur bëhet fjalë për riciklimin e plastikës, në disa pika në Beograd ka disa aparate ku qytetarët mund të hedhin ambalazhe plastike - shisheet dhe gjëra të tjera - dhe të mbushin kartën e transportit me shuma simbolike.

E mirëmbajtësi i parkut në Dardani të Prishtinës thotë se edhe sikur të mos ketë ndonjë përfitim material, hedhja e mbeturinave do të ishte mirë të bëhej në vende të caktuara dhe jo kudo.

"... sepse është mirë edhe për qytetarët, edhe për natyrën. Shikojeni parkun e pastruar sa bukur duket... Ejani nesër në mëngjes dhe shihni lloje të ndryshme të mbeturinave", thotë Halil Avdiu.

Rriten çmimet, rëndohet jeta e familjeve me pagë minimale dhe atyre me social



PRISHTINË, 3 MARS - Jeta është bërë ende më e vështirë për të mbijetuar për familjet në vendin tonë me të ardhura nga kategoritë sociale dhe me një pagë minimale për shkak të rritjes së çmimeve për produktet bazike.

Familjet me të ardhura minimale, dhe ato me të ardhura sociale, nuk arrijnë t'i përballojnë shpenzimet mujore për konsum. Madje shpeshherë detyrohen të futen edhe në borxhe vetëm që të sigurojnë ushqim për familjarët. Kështu rrëfen për KosovaPress qytetari Bajram Musliu i cili jeton me gruan dhe katër fëmijët e tij, për

çfarë thotë se e ka të pamundur që me 250 euro në muaj t'ia dalë që t'i ushqejë dhe mbulojë shpenzimet për anëtarët e familjes.

Paga minimale aktualisht në Kosovë për të punësuarit e moshës mbi 35-vjeçare është ende 170 euro. Të punësuarit e moshës nën 35 vjet do ta marrin pagën minimale në vlerë prej 130 eurosh.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, konsideron se institucionet e vendit duhet të ndërmarrin masa efikase në mënyrë që t'ua lehtësojnë barrën qytetarëve karshi luftimit të inflacionit të

produktet e konsumit. Rafuna, duke folur për çmimet e larta, thotë se një shportë me ushqime për familjen e cila është blerë 500 euro në vitin e kaluar, këtë vit nuk mund të blihet me 700 euro.

Në raportin e fundit të publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1.8-përqindësh në muajin janar 2024 krahasuar me muajin dhjetor 2023. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, inflacioni mujor ishte 0.3 për qind në muajin janar 2024.

Si mund t'i ndihmojë Gazës ndihma e SHBA-së dhe pse operacioni është i komplikuar?



Shtetet e Bashkuara kanë nisur të hedhin të shtunën ndihma urgjente humanitare në Gazë, prej ajrit.

Presidenti amerikan, Joe Biden, ka thënë se SHBA-ja është duke shqyrtuar edhe mënyra tjera për t'iu ndihmuar palestinezëve në territorin e udhëhequr prej Hamasit, teksa vazhdon lufta e grupit me Izraelin.

Hamasit është shpallur grup terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian.

Tre aeroplanë për mallra C-130 kanë lëshuar pako me 38.000 shujta në Gazë, në pasditen e së shtunës.

Ndihmat janë hedhur në jugperëndim të Gazës, rreth zonës bregdetare, ka thënë një zyrtar amerikan.

Operacioni është koordinuar me forcën ajrore të Jordanisë, e cila ka nisur ditë më parë të dërgojë ndihma në Gazë në të njëjtën mënyrë.

Surge in Measles Cases in UK Comes Amid Plummeting Vaccination Rate 00:00/00:00

Vendimi i Bidenit është marrë pasi të paktën 115 palestinezë janë vrarë dhe mbi 750 të tjerë janë plagosur të enjten, derisa kanë tentuar të marrin ndihmë në veri të Gazës, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze.

Dëshmitarët kanë thënë se ushtria izraelite ka shtënë me armë zjarri në drejtim të turmës, duke e konsideruar si rrezik.

SHBA-ja i ka kërkuar disa herë Izraelit që të dërgojë ndihmë humanitare në Gazë dhe të hapë

pikën e tretë kufitare në këtë rajon, mirëpo dhuna e së enjten tregon se sfidat janë të mëdha, pavarësisht rrethanave të krijuara.

“Humbja e jetëve është zemërthyesë”, ka thënë Biden, teksa ka bërë të ditur nisjen e ndihmave.

“Njerëzit atje janë aq të dëshpëruar”.

I pyetur se si do të sigurohet SHBA-ja që furnizimet të mos jenë në duart e Hamasit, zëdhënësi i Sigurisë Kombëtare të SHBA-së, John Kirby, ka thënë se SHBA-ja do të mësojë më shumë përgjatë operacioneve ajrore.

“Janë vetëm pak operacione tjera ushtarake që janë më të komplikuar sesa hedhja e ndihmës humanitare prej ajrit”, ka thënë ai.

Sipas tij, Pentagoni do t'i identifikojë zonat ku do të lëshohen ndihmat për të balancuar situatën në të gjitha rajonet.

“Rreziku më i madh është derisa të sigurohemi që askush nuk do të lëndohet në terren”, ka thënë Kirby.

Ai ka thënë se SHBA-ja është duke analizuar edhe mënyra për shpërndarjen e ndihmave, kur ato të prekin tokën.

SHBA-ja beson se ndihma do t'iu ndihmojë banorëve të Gazës, mirëpo ajo nuk është zëvendësimi i kamionëve, të cilat mund të bartin ndihmën në mënyrë shumë më efektive.

Kirby ka thënë se përparësia e ndihmës prej ajrit është se ndihma mund të arrijë një lokacion shumë shpejt.

Mirëpo, kur është fjala për sasinë, nuk mund të krahasohet me ndihmën që bartin kamionët.

SHBA-ja dhe aleatët janë duke tentuar të arrijnë një armëpushim të ri në mes të Hamasit dhe Izraelit, që do të mundësonte lirim të pengjeve të mbajtura prej Hamasit në Gazë, dhe lirim të disa palestinezëve prej burgjeve izraelite përgjatë gjashtë javëve të pauzës.

Nëse arrihet armëpushimi, SHBA-ja shpreson se do të krijoheshin rrethanat që një sasi shumë e madhe e ndihmës të hynte në Gazë.

Biden ka thënë të premten se SHBA-ja është duke punuar me aleatët për krijim të një korridori detar që mundëson dërgimin e ndihmës në Gazë përmes detit.

Houthët e Jemenit të vendosur: Do vijojmë sulmet ndaj anijeve britanike, do fundosen

Houthët e Jemenit, të përkrahur prej Iranit, janë zotuar të dielën se do të vazhdojnë të shënjestrojnë anijet britanike në Gjirin e Adenit, pas fundosjes së anijes Rubyamar, në pronësi të Mbretërisë së Bashkuar.

Ushtria amerikane ka konfirmuar të shtunën që anija britanike është vendosur pasi është goditur prej raketave të nisura prej militantëve të Huthëve më 18 shkurt.

“Jemeni do të vazhdojë të fundosë më shumë anije britanike dhe çdo dëm do të shtohet në faturën e Britanisë”,

ka thënë Hussein al-Ezzi, zëvendësministër i Qeverisë së udhëhequr prej Huthëve, në një postim në X, platformë e njohur më parë si Twitter, shkruan REL.

“Është një shtet mashtrues që sulmon Jemenin dhe është partner me Amerikën në sponsorimin e krimeve kundër civilëve në Gazë”.

Militantët e Huthëve kanë nisur vazhdimisht dronë dhe raketa kundër anijeve komerciale ndërkombëtare prej nëntorit të vitit të kaluar, duke thënë se sulmet janë shenjë solidarizimi me palestinezët që po përballen

me ofensivën izraelite në Gazë. Sulmet e tyre në Detin e Kuq e kanë çrregulluar transportin e mallrave, duke detyruar shumë kompani që të bëjnë rrugë shumë më të gjatë dhe më të kushtueshme nëpër jugun e Afrikës, dhe kanë rritur shqetësimet se lufta Izrael-Hamas mund të përhapet edhe më tej në Lindjen e Mesme.

Shtetet e Bashkuara dhe Britania kanë nisur të sulmojnë shënjestrat e Huthëve në Jemen, qysh prej janarit, si shenjë hakmarrjeje për goditjen e anijeve të tyre në Detin e Kuq.



Si ndryshon ndër vite personaliteti ynë



Duke folur me një shtatëdhjetë vjeçar të sjellshëm dhe të shoqërueshëm, mund të pyesësh veten: “A ka qenë gjithmonë kështu, apo ka ndryshuar me kalimin e viteve?”. Dhe një shtatëmbëdhjetëvjeçare e rezervuar mund të pyesë veten: “Kur të rritem, a do të jem po njësoj?”. E vërteta është se ndërsa mbetemi vetvetja, nuk jemi i njëjti person gjatë gjithë jetës sonë. Dhe ka lajme të mira: personaliteti përmirësohet me kalimin e kohës.

Bërthama

Në një farë mase, ne mund ta njohim veten te fëmija që ishim dikur. Të qetë apo të zhurmshëm? Të qetë apo i prirur për shpërthime? Eksplorojmë të sigurt të botës apo të trembur nga të huajt dhe përvojat e reja? Temperamenti që kemi që fëmijë ndikon në përvojat e jetës, duke nxitur pritshmëri të ndryshme tek të tjerët (për shembull, nga një fëmijë i turpshëm pritet të mos flasë shumë dhe nga një i paduruar pritet që të shpërthejë gjithmonë në zemërim) dhe sjellje që mund ta radikalizojnë atë: p.sh. një fëmijë i turpshëm mund të lihet në botën e tij ose të ndërpritet pa shumë takt kur flet, ashtu siç është e mundur që një fëmijë i zhurmshëm të trajtohet me nervozizëm edhe para se të lëshojë zemërimin e vet. Në çdo rast, këto stile të sjelljes së fëmijërisë thonë shumë për personalitetin që do të zhvillohet në moshën madhore. “Një 3-vjeçar i turpshëm sillet shumë ndryshe nga një 20-vjeçar i

turpshëm. Por thelbi mbetet”, thotë Brent Donnellan, psikolog në Universitetin Shtetëror të Michiganit. Duke ndjekur fëmijë nga 3 vjeç deri në moshën madhore, një studim nga Universiteti i Wisconsinit gjeti gjithashtu vazhdimësi me kalimin e kohës: fëmijët e rezervuar mbetën të rezervuar dhe ata me vetëkontroll të dobët u bënë të rinj impulsivë dhe që ndërmerrnin risqe.

Çështje pjekurie

Por personaliteti ynë nuk është gjithmonë një herë e përgjithmonë që në fëmijëri. Ka të ngjarë që pas disa vitesh ndryshimet të jenë të padukshme, por ngadalë, gjatë rrjedhës së jetës, ato mund të bëhen të rëndësishme. Sipas Brent Roberts, psikolog në Universitetin e Illinoisit në Urbana-Champaign: “Personaliteti është një fenomen në zhvillim. Nuk është diçka statike në të cilën njeriu ka ngecur, pa mundësinë për të shkuar më tej”. Së bashku me kolegët nga Universitetet e Houstonit dhe Tübingenit (Gjermani), ai studioi ndryshimet e pothuajse 2000 njerëzve në mbi 50 vjet: individët që kishin marrë pjesë në një studim kur ishin në shkollë të mesme (mosha mesatare 16 vjeç) u gjurmuan dhe iu nënshtruan të njëjtit test. “Rezultatet tona sugjerojnë se personaliteti ka një komponent të qëndrueshëm gjatë gjithë jetëgjatësisë, por ai është gjithashtu i lakueshëm, d.m.th. njerëzit piquen me moshën,” përfunduan autorët.

Në njëfarë kuptimi, mbi të gjitha “skajet” zbuten e lakohen: pjesëmarrësit morën rezultate më të larta se sa kur ishin adoleshentë në pjesë të testit që masnin qetësinë, vetëbesimin, ndjenjën e përgjegjësisë dhe prirjen për të ndërmarrë veprime. Studime të tjera e konfirmojnë këtë evolucion: ndërsa plakemi bëhemi më të ndërgjegjshëm, emocionalisht të qëndrueshëm (më pak pre e impulseve dhe emocioneve), ekstrovertë, miqësorë dhe bashkëpunues. “Ndryshimet janë potencialisht pozitive. Më shumë vetëvlerësim, ndërgjegje dhe stabilitet emocional mund të përmirësojnë jetën tonë në fusha të tilla si puna, marrëdhëniet dhe shëndeti”, thotë Roberts. Në një nga studimet e tij ai tregoi gjithashtu se moshën ul narcisizmin: në përgjithësi, drejt moshës së mesme ai është më pak i theksuar sesa kur në rinë, edhe pse narcisistët e vërtetë prirën të mbeten të tillë, të paktën pjesërisht.

Avantazhet e ndryshimit

Rikrijimi i personalitetit me rritjen e moshës sjell përfitime të mëtejshme. Një studim nga Universiteti i Buffalo mbi njerëzit e moshës 14 deri në 99 vjeç zbuloi se me kalimin e viteve, ata bëhen më të besueshëm ndaj të tjerëve dhe se kjo shoqërohet me një ndjesi më të madhe mirëqenieje. Ndërsa në Universitetin e Singaporit u pa se 70-vjeçarët janë më bujarë se 20-vjeçarët me të huajt, sepse janë më pak të përqendruar te vetja.


“Ekziston një ide e gabuar se njerëzit e moshuar janë më të turpshëm. Në realitet është e kundërta. Në vend të kësaj, ne shpesh bëhemi më empatikë dhe të dhembshur teksa plakemi”, shpjegon Rodica Damian, psikologe në Universitetin e Hjustonit. Gjithashtu fitojmë qetësi shpirtërore, sepse jemi më të patrazuar se sa kur ishim të rinj. Për të vlerësuar këtë, një ekip i koordinuar nga Universiteti i Kalifornisë, Santa Cruz, vëzhgoi me imazhe të rezonancës magnetike funksionale përgjigjen e amigdalës (zona e trurit që përpunon disa emocione) ndaj pamjes së imazheve me përmbajtje emocionale pozitive dhe negative, tek njerëz të moshave të ndryshme. Vetëm tek të moshuarit imazhet pozitive nxisin aktivizim më të madh të amigdalës në krahasim me ato negative. Për më tepër, pjesëmarrësit më të moshuar kishin më shumë gjasa të kujtonin imazhe të këndshme midis atyre që panë gjatë eksperimentit. Siç shkruajnë autorët e studimit: “Ndërsa plakemi, ne përjetojmë më pak emocione negative dhe u kushtojmë më pak vëmendje stimujve emocionalë negativë, sesa atyre pozitivë”. Në shumë raste qeshim edhe më shumë. Kjo doli nga një studim në Universitetin e Nju Meksikos, në të cilin disa njerëzve iu kërkua të vlerësonin një sërë deklaratash humoristike dhe neutrale. “Të moshuarit i perceptonin si humoristët, ashtu edhe ata neutralë, si më argëtues sesa të rinjtë,” përfundoi autori i studimit.

Shtytja e evolucionit

Me kalimin e kohës, pra, edhe personaliteti transformohet. Po pse? Jo aq shumë si rezultat i ngjarjeve të mëdha të jetës. Ajo që na formon, është më tepër ajo që presin të tjerët nga ne, nevojat që duhet të plotësojmë për të krijuar marrëdhënie të mira shoqërore, për të edukuar veten, për të punuar, për të ndërtuar marrëdhënie romantike, për të krijuar familje. “Me kalimin e kohës, në shumë kontekste të jetës, ne na kërkohet t’i bëjmë gjërat pak më ndryshe,” thotë Roberts. “Askush nuk na thotë hapur se si të veprojmë, por në shumë situata ka rregulla shumë të se si duhet të sillemi,” specifikon ai. Pra, ne përshtatemi. Për t’u konformuar me kërkesat sociale dhe detyrat zhvillimore të çdo faze të jetës. Aq sa një studim i kryer në 62 vende, i koordinuar nga Universiteti i Tilburgut (Hollandë), zbuloi se në kulturat ku të rinjtë pritet të marrin shpejt përgjegjësitë e të rriturve (si puna dhe largimi nga familja e origjinës), personaliteti piqet më herët.

Vendos unë si dua të jem

A mund të vendosim vetë që të ndryshojmë? “Shumica dërrmuese e njerëzve do të donin të ndryshonin aspekte të personalitetit të tyre,” thotë Nathan Hudson, psikolog në Universitetin Metodist të Jugut në Dallas, Teksas. Hudson kreu një studim në të cilin pjesëmarrësit raportuan se cilin dimension themelor të personalitetit donin të ndryshonin. Më pas, çdo 7 ditë për 15 javë, ata morën propozim për të kryer një detyrë, të projektuar për t’i nxjerrë nga “zona e tyre e rehatisë”, me nivele në rritje të vështirësisë. Për shembull “prezantohu me dikë”, dikujt që donte të bëhej më ekstrovert. Kështu, ne kemi parë se ata persona me të vërtetë mund të evoluonin në drejtimin e dëshiruar. “Përveç faktorëve të jashtëm si rolet shoqërore, qëllimet për të ndryshuar personalitetin e dikujt mund të jenë gjithashtu mjaft të forta për të formuar vazhdimisht mendimet, ndjenjat dhe sjelljet gjatë një periudhe kohe të mjaftueshme për të prodhuar ndryshime në tipare,” thotë Hudson. Një person i turpshëm mund të “detyrojë” veten të shkojë në një festë ku nuk njihet pothuajse askënd. Dhe një tip impulsiv që të mos shprehë zemërimin në vendin e punës. Dhe kështu, i japim vetes mundësi të reja, që të ndryshojmë vit pas viti. Vetëdija se personaliteti është në transformim ka dy përparësi: promovon evolucionin tonë dhe na bën të jetojmë me kuriozitetin për të zbuluar se si do të bëhemi. (bota.al)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

'Vreshtarët' vazhdojnë me fitore

RAHOVEC, 3 MARS - Arbër Curri ka pritur gjuajtjen e fundit për t'i mundësuar Rahovecit që të vazhdojë me fitore në Superligën e Kosovës në hendboll. Të dielën mbrëma në palestrën "Mizahir Isma", Rahoveci e Besa Famgas zhvilluan derbi shumë interesant e të fortë. Njëjtë si në dy ndeshjet e kaluara mes këtyre dy skuadrave, sfida u vendos në aksionet e fundit. Dhe Rahoveci fitoi 27:26 për suksesin e 18-të rresht në Superligë. Rahoveci ka vetëm fitore dhe udhëheq në tabelë me 36 pikë. Besa Famgas është e dyta me 28 pikë. Skuadra vendase e hapi ndeshjen me seri 5:0. Por pejanët nuk u dorëzuan. Mbetën në lojë, duke u afruar gradualisht në rezultat. Barazimin Besa e realizoi vetëm në minutën e 43-të, 20:20. Më pas kaloi në epërsi prej dy golash, 23:21. Shpejt rezultati u barazua në 23:23. Rahoveci doli



para 25:24 e 26:25. Por Besa barazonte. Për 27:26 realizoi Victor Alonso në minutën e 57-të dhe rezultati më nuk ndryshoi. Në sekondën e fundit, Curri ndali gjuajtjen për barazim të Marin Mariqit. Pos Currit u dallua edhe portieri tjetër i Rahovecit, Arti Luzha. Më efikas ishte spanjollli Alonso me tetë

gola. Nga katër i kishin Jeton Bislimi, Mali Luzha e Igor Radojeviq. Në momentet vendimtare me tri gola rresht te Rahoveci u shqua Florian Rexha. Edhe te Besa Famgas më i dalluari ishte portieri Mursel Memeti. Nga pesë gola i shënuan Nikola Prce e Olsi Mulaj, ndërsa katër i kishte Antonio Vozila.

LeBron James, basketbollisti i parë që tejkalon shifrën e 40 mijë pikëve

LOS ANXHELOS, 3 MARS - LeBron James është bërë basketbollisti i parë i ligës amerikane NBA që ka shënuar mbi 40.000 pikë në karrierën e tij. Megjithatë, ai e ka përshkruar këtë moment me ndjesi të përziera, pasi në ndeshjen e së shtunës, ekipi i tij Los Angeles Lakers ka humbur kundër ekipit Denver Nuggets. "Te jesh lojtari i parë që e arrin këtë, është goxha mirë në këtë ligë", ka thënë 39-vjeçari të shtunën, i cili vetëm në atë ndeshje i ka shënuar 26 pikë. "Gjëja kryesore është gjithmonë gjëja kryesore dhe ajo është fitorja", ka thënë ai. "Më vjen inat që kjo ndodhi kur ne humbëm, sidomos ndaj një ekipi që luan jashtëzakonisht mirë". James ka qenë në vendin e parë sa u përket pikëve qysh prej shkurtit të vitit 2023, pasi atëbotë e pati kaluar basketbollistin Kareem



Abdul-Jabbar, i cili mbante rekordin me 38.387 pikë. James është shpallur katër herë kampion i NBA-së dhe katër herë Lojtari më i Vlefshëm, dhe aktualisht është basketbollisti më i vjetër aktiv në ligë. Ai ka thënë se nuk e di nëse

edhe një tjetër lojtar i NBA-së do të mund të arrijë shifrën prej 40.000 pikëve. "Duhet ta luani lojën goxha mirë për kohë të gjatë, dhe të keni fat me lëndimet dhe gjërat e asaj natyre", ka thënë ka James.

SHKURT

Astera Tuhina vazhdon shkëlqimin

Basketbollistja e Kosovës, Astera Tuhina ka prodhuar sërish një ndeshje të madhe për Washington State Women's. Në fitoren ndaj Kolorados 72:63, ajo e mbylli ndeshjen me 14 pikë, gjashtë kërcime, tri asistime dhe një top të vjedhur. Tuhina është në formë të lartë në ShBA dhe kjo është një lajm i mirë edhe për Kosovën. Në Prishtinë, më 25-30 qershor zhvillohet FIBA Kampionati Evropian për Shtete të Vogla, ku Astera është pjesë e Dardaneve, që për herë të parë luajnë në shtëpi. Astera shihet si një nga basketbollistet më të ardhme të ndritur.

Napoli fitoi derbin ndaj Juventusit

Napoli ka fituar derbin nga Juventusit me rezultat 2-1 në përballjen e vlefshme për javën e 27-të të Serie A. Në rastin e parë serioz, Napoli arriti të shënonte, në minutën e 42-të, Khvicha Kvaratskhelia gjuajti saktë për 1-0. Juventusit ka mundur të barazojë rezultatin, por Vlahović goditi shtyllën. Edhe në pjesën e dytë, Juventusit kishte më shumë nga loja, duke rrezikuar disa herë portën e Alex Meret. Në minutën e 81-të, Federico Chiesa me një gjuajtje të bukur, arriti të shënojë për 1-1. Por pas katër minutash Napoli fitoi penallti, kur Victor Osimhen u pengua në zonë. Nga pika e bardhë gjuajti Osimhen, por goditja e tij u prit nga Wojciech Szczęsny, por nga topi i kthyer shënoi Giacomo Raspadori për 2-1. Juventusit lehtë ka mundur të barazojë, por goditja e Daniele Ruganit nga afër shkoi mbi portë. Napoli është i shtati me 43 pikë, ndërsa Juventusit me 57 pikë mbetet i dyti.

Fiorentina dhe Napoli interesohen për Taren

Prej verës së shkuar, Igli Tare nuk është më pjesë e Lazios dhe tanimë drejtori sportiv është në kërkim të një aventure të re. Ish-sulmuesi i Kombëtares s'e ka fshehur dashurinë për futbollin italian dhe pikërisht mund të ketë një rikthim në Serie A. Është Fiorentina që po planifikon ndryshime në strukturë dhe nga Italia bëjnë me dije se mund të ketë variante të reja për të zëvendësuar drejtorin aktual, Daniele Prade. "Violat" e presidentit Rocco Commisso duket se i kanë "vendosur syrin" Igli Tares, një njohësi të mirë të futbollit në Itali. Veç Fiores, edhe Napoli i Aurelio De Laurentiis e ka në plane Igli Taren, që duhet thënë se kishte interes dhe nga klubet e Premier Ligë.

Leverkusen shkon +10 pikë nga Bayerni

Bayer Leverkusen përfiton nga ndalesa e radhës së Bayernit dhe tashmë e sheh veten me 10 pikë më shumë në krye të renditjes. Skuadra e Alonsos fitoi pastër 2-0 në transfertën ndaj Koln. Ishte një ndeshje që "Aspirinat" e patën të thjeshtë, pasi 14 minuta nga starti i ndeshjes Thielmann u ndëshkua me karton të kuq. Leverkusen do të zhbllokonte ndeshjen në minutën e 37-të me Jeremie Frimpong, ndërkohë që Grimaldo në minutën e 73-të realizoi golin e dytë. Granit Xhaka si gjithmonë ishte titullar, duke bërë një tjetër paraqitje të nivelit të lartë për të udhëhequr ekipin e tij drejt titullit të parë kampion.

City fiton me përmbysje derbin ndaj Unitedit

Manchester, 3 mars - Manchester City ka arritur një fitore spektakolare 3-1 me përmbysje ndaj United, në duelin e luajtur në "Etihad Stadium". Djajtë e Kuq kaluan në avantazh që në minutën e 8-të, me

Rashford që realizon një gol spektakolar dhe u jep avantazhin miqve. Avantazh që zgjati deri në minutën e 56', moment në të cilin Foden realizoi një perlë të vërtetë dhe barazoi për vendasit. Ndërsa në

minutën e 80', i asistuar nga Alvarez, Foden përmbysi rezultatin me një tjetër super goditje. Sfidu u vulos në minutën e 90+1', me Haaland që shënoi golin e tretë për skuadrën e Pep Guardiols si dhe i dhuroi

qetësi për minutat e mbetura. Manchester City renditet në vend të dytë me 62 pikë, një më pak se Liverpooli kryesues, ndërkohë Manchester United renditet në vend të gjashtë me 44 pikë.



NJOFTIM MBI ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË
"Beverly Park Residences " LLC
NUI: 812035568

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit se Shoqërisë, të plotësuara dhe ndryshuara, Aksionari i shoqërisë “Beverly Park Residences” L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, rruga Rruga Miradi e Epërme, Parcela 508-2, me numër unik identifikues 812035568 (“Shoqëria”) ka nxjerr:

VENDIM PËR ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË
me datë 21/02/2024

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet në vlerën prej 465,000.00 EURO përkatësisht nga vlera e regjistruar **3,758,000.00 Euro** në **3,293,000.00Euro**

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor të drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvoglim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

“Beverly Park Residences” L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, rruga Rruga Miradi e Epërme, Parcela 508-2.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejite





RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

 044 900 978 | 045 687 898
 Sallon Depilimi Lume's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Visar Halili shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Arianit Rragamaj shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë

- Edi Morina shpall të pavlefshme diplomën Sh. M. Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë

- Armend Kukaj shpall të pavlefshme 4 dëftesat Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Fisnik Ukaj shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Bajram Pllava shpall të pavlefshme 3 dëftesa, diplomën, certifikatën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Fatime Reshani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dëshmorët e Kabashit " Korishe.

- Korab Qovanaj shpall të pavlefshme dëftesën e kl I - V shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cilë gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

